




|   |             |
|---|-------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |             |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |             |
| Dep.<br>Dep.<br>Dep.  | 2-D/DPK     |
| Nr. I faq.<br>Broj stranica<br>Nr. pages  | 02          |
| Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot No   | 01-122/2013 |
| Data<br>Datum<br>Date   | 22-01-2013  |
| PRISHTINE   |             |



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.01.2013, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3760/12, për ztr. *Arben Fetoshi* – Drejtor në Radio Kosova, dhe Anëtar i Bordit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, *për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e cilësojnë situatën me konflikt interesi. Por, në këtë rast ka disa kufizime për zyrtarin e lartë.***

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit, me numër protokolli AKK-03-3760-12, pas zhvillimit të procedurës, është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit.**

Rasti i hapur me kërkesën e vet palës, me qëllim të sqarimit të situatës së ekzistimit apo jo të Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Sipas kërkesës për shqyrtimin e situatës konflikt interesi nga vet pala, të pranuar në Agjencinë kundër korrupsionit (DPK/DPKI 03-3760/12), është shprehë interesimi për të sqaruar situatën; se a përbën konflikt interesi emrimi i zyrtarit të lartë – Drejtorit të Radio Kosovës, në pozitën e anëtarit të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës ?

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 2, Ligji Nr.04/L-051), është konstatuar se; zyrtari i lartë, që ushtron funksion të lartë publik - Drejtor në Radio Kosova, është emruar për Anëtar të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Pas kësaj shkrese, kemi organizuar takim në Zyrтарin e lartë Z.Fetoshi, nga i cili kemi marr informacione për gjendjen reale. Në këtë takim zyrtari Fetoshi është shprehur i interesuar të marr një opinion zyrtar nga Agjencia kundër Korrupsionit lidhur me këtë situatë dhe po ashtu është shprehur i gatshëm dhe ka deklaruar se çfardo që të jetë ai opinion, ai do ta respektoj.

Agjencia kundër Korrupsionit ka trajtuar rastin sipas legjislacionit përkatës.

Neni 15 paragrafi 3 i Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit shprehimisht thotë: *"Zyrtari i lartë në cilësinë e anëtarit të organeve drejtuese dhe mbikqyrës i personave juridik, jo fitimprurës dhe personave juridik tjerë të cilët kryejnë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit kulturës dhe veprimtarive humanitare, por nuk ka të drejtë të pranimit të kompenzimit të shpenzimeve tjera të nevojshme, për veç nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera"*.

Po ashtu me Ligjin për parandalimin e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik nr. 04/L-051, të ushtrimi i veprimtarive tjera nga zyrtari i lartë, në nenin 10 pika 2 shprehimisht thuhet: *"Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari i lartë mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarive humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje tjera"*.

Ndërsa Ligji për Arsimin e lartë në Republikën e Kosovës (Nr.04/L-037) te Struktura qeverisëse e bartësve të arsimit të lartë (neni 18 pika 2), ndër të tjera, shprehimisht thotë: *"...Ata duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik, me aftësi përkatëse profesionale, afariste, si dhe me aftësi të tjera praktike. Asnjë nga anëtarët e emruar nuk duhet të ketë lidhje të drejtëpërdrejta aktuale me institucionin në të cilin emërohet"*.

Në bazë të këtyre pikave të ligjit, si dhe informacioneve zyrtare të marra nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë (DPK/DPKI 03-30/2013), si dhe nga vet zyrtari i lartë i përfshirë në këtë rast, kemi konstatuar se, ***nëse respektohen rekomandimet sipas këtyre pikave të ligjit, të cituara me lartë, atëherë nuk ka situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.***

Në bazë të këtyre fakteve dhe provave, kemi konstatuar se nuk ka situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, por ka disa kufizime për zyrtarin e lartë.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

